



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 32 regjistër (JR)

Datë 14.07.2022

Nr. 30 i vendimit

Datë 22.04.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Ina Rama	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 22.04.2025, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Jerina Gjika, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 32/2022 (JR), datë 14.07.2022, që i përket:

ANKUES

Subjekti i rivlerësimit Arian Ndoja, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

OBJEKTI:

Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 528, datë 06.05.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Arian Ndoja.

BAZA LIGJORE:

Aneksi i Kushtetutës “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”; Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, nenet 6, 8, 17 dhe 18; Kodi i Procedurave Administrative; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 97/2016 “Për Prokurorinë në Republikën e Shqipërisë”; Kodi Penal; Kodi i Procedurës Penale.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arian Ndoja, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe, si rrjedhojë, ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Bazuar në nenin 4, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Arian Ndoja duke marrë vendimin nr. 528, datë 06.05.2022, bazuar në konkluzionet lidhur me kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.
3. Komisioni, pasi konstatoi se në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe procedurave, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016: u vërtetuan kontakte të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë/dyshuar në veprimtari të kundërligjshme, një pjesë e të cilëve trajtuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës; u vërtetuan dy raste të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës përkatësisht me shtetasin E. SH., person me precedentë penalë, si dhe vajzën e tij Z. SH.; u vërtetua cenimi i etikës së prokurorit gjatë komunikimit me Drejtuesen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, znj. A. J.; u vërtetuan kontakte të subjektit me politikanë apo njerëz të pushtetit ekzekutiv a gjyqësor, të cilat nuk justifikohen nga ushtrimi i funksionit të një magjistrati; subjekti i rivlerësimit ka pasur në dispozicion nëpërmjet mjeteve elektronike, të dhëna, informacione dhe kopje të dokumenteve, duke përfshirë dokumente të lidhura me hetime çështjesh, disa prej të cilave nuk ndiqen drejtpërdrejt prej tij – arriti në konkluzionin përfundimtar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për rrjedhojë, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 528, datë 06.05.2022, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arian Ndoja, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës”.
4. Subjekti i rivlerësimit Arian Ndoja iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar “Kolegji”) me ankim kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 528, datë 06.05.2022, me pretendimin se vendimi vjen në kundërshtim të hapur me ligjin material dhe procedural, si dhe është rezultat i cenimit të parimeve kushtetuese për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Sipas subjektit të rivlerësimit, në arsyetimin e vendimit objekt ankimi, ka

konkluzione alogjike dhe kontradiktore, si dhe pasqyrim të pasaktë e të rremë të rrethanave të faktit dhe, për rrjedhojë, aplikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si kriter për shkarkimin e tij nga detyra, nuk gjendet i mbështetur në ligj dhe në prova.

5. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 62 e vijues të ligjit nr. 84/2016, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:

◦ *Prishjen/ndryshimin e vendimit nr. 528, datë 06.05.2022, dhe konfirmimin në detyrë si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.*

6. Gjatë periudhës së përgatitjes së çështjes për gjykim në Kolegj, në datën 03.03.2025, është depozituar nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë¹, vendimi i këtij të fundit nr. {***}, datë 27.02.2025, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”. Sipas këtij vendimi, rezulton se Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në mbledhjen e tij plenare të datës 27.02.2025, ka marrë në shqyrtim kërkesën e magjistratit Arian Ndoja nr. {***} prot., datë 24.02.2025, për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes nga detyra e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Kjo kërkesë është motivuar “për shkak të angazhimit në një aktivitet tjetër të papajtueshëm me funksionin e magjistratit”. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në parashikimet e nenit 149/a të Kushtetutës, neneve 64, pika 1, germa “a” dhe 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe neneve 164, pika 8, 166, pika 2 dhe 189, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, vendosi: “Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqjeje për z. Arian Ndoja, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, duke i dhënë këtij vendimi efekt të menjëhershëm.
7. Subjekti i rivlerësimit, në datën 16.04.2025, depozitoi në Kolegj parashtimet² e tij me shkrim lidhur me ankimin e ushtruar, në zbatim të parashikimeve të nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Në parashtresat e tij, subjekti i rivlerësimit deklaroi se pavarësisht ushtrimit të së drejtës së tij kushtetuese të ankimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 528, datë 06.05.2022, të cilin e konsideron të padrejtë, duke rikonfirmuar shkaqet e ankimit, për arsye se ka dhënë dorëheqjen nga detyra e prokurorit, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, kërkoi nga Kolegji *ndryshimin e vendimit nr. 528, datë 06.05.2022, të KPK-së dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin magjistrat, prokurorin Arian Ndoja, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit si pasojë e dorëheqjes nga detyra si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës.*

¹ Me anë të shkresës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. {***} prot., datë 27.02.2025.

² Protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 16.04.2025.

II. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arian Ndoja, subjekt për të cilin, nëpërmjet ankimit, kërkohet ndryshimi i tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit që merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 528, datë 06.05.2022, u mor në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
11. Trupi gjykues, pasi vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat si konstatuar më lart, lidhur me dorëheqjen nga detyra të subjektit të rivlerësimit, konstatoi se vendimi nr. {***}, datë 27.02.2025, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka sjellë si pasojë ligjore mbarimin e statusit të magjistratit për z. Arian Ndoja. Në kushtet kur procesi i rivlerësimit kalimtar, referuar nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe dispozitave zbatuese të ligjit nr. 84/2016, lidhet ngushtësisht me detyrën e ushtuar nga subjektet e rivlerësimit, mbarimi i statusit të magjistratit me vendimin e sipërcituar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përpara përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar për magjistratin Arian Ndoja, sjell njëkohësisht edhe pasojën juridike të humbjes së cilësisë së subjektit të rivlerësimit *ex officio*, për shkak të të cilit u përfshi në procesin e rivlerësimit kalimtar, sipas dispozitës së sipërcituar kushtetuese. Për rrjedhojë, procesi i rivlerësimit kalimtar për ankuesin,

duhet të ndërpritet dhe ankimi i tij kundër vendimit të Komisionit nr. 528, datë 06.05.2022, nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

12. Trupi gjykues vlerëson se, në kushtet kur humbja e statusit të subjektit të rivlerësimit *ex officio* vjen për shkak të vullnetit të subjektit për t'u dorëhequr nga detyra, ndërprerja e procesit të rivlerësimit bazohet në nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe, si pasojë, duhet të shoqërohet me zbatimin e parashikimit të pikës 2 të këtij neni, sipas të cilit urdhërohet ndalimi i subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15- vjeçare.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Arian Ndoja.
2. Ndalimin e emërimit të z. Arian Ndoja gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 22.04.2025.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi